



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Dr. Sc. Ramadan Beqiri

Nr. Prot.: 641/26; Datë: 30.03.2026

Në bazë të nenit 5 dhe nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nenit 20 të Ligjit për Arimin e Lartë në Kosovë nr. 04/L-037, bazuar në nenin 16, paragrafit 3, nenin 22, dhe në dispozitat tjera të Statutit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) si dhe sipas propozimit të Senatit të UShAF nr. 609/26 të datës 25.03.2026, Këshilli Drejtues i UShAF, në mbledhjen e mbajtur me datën 30.03.2026, merr

V E N D I M

- I. Miratohet Rregullorja për mbështetjen financiare, stimulimin dhe shpërblimin e punës kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuar në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj.
- II. Vendimi hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit të tij.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i UShAF me qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore në UShAF pas elaborimit të draft rregullores në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

Vendimi i dorëzohet:

1. Këshillit Drejtues të UShAF;
2. Njësive akademike të UShAF;
3. Divizionit për Buxhet dhe Financa të UShAF;
4. Arkivit të UShAF.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Dr. Sc. Ramadan Beqiri



Shënim: Ky dokument është zhvilluar me mbështetjen e ekspertëve të programit SHER. Programi SHER mbështetet me ndihmë financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim(Austrian Development Agency), me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim(Austrian Development Cooperation) dhe me bashkëfinancim nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, dhe implementohet nga një konsorcium që përfshin World University Service Austria (WUS AT, kryesues), Center for Social Innovation (ZSI) dhe Agjencinë Austriake për Arsimin dhe Ndërkombëtarizim (OeAD). Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura këtu, në asnjë mënyrë nuk reflektojnë opinionin zyrtar të Agjencisë Austriake për Zhvillim, as opinionin e partnerëve implementues..



UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA

— FERIZAJ —

RREGULLORE PËR MBËSHTETJEN
FINANCIARE, STIMULIMIN DHE
SHPËRBLIMIN E PUNËS KËRKIMORE-
SHKENCORE, ARTISTIKE DHE TË
APLIKUAR

Ferizaj, 2026

J.S



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —

Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Dr. Sc. Ramadan Beqiri

Nr. Prot.: 641/26; Datë: 30.03.2026

Në bazë të nenit 5 dhe nenit 10 të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, nenit 20 të Ligjit për Arimin e Lartë në Kosovë nr. 04/L-037, bazuar në dispozitat e Statutit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF) si dhe sipas propozimit të Senatit të UShAF nr. 609/26 të datës 25.03.2026, Këshilli Drejtues i UShAF, në mbledhjen e mbajtur me datën 30.03.2026, miraton:

RREGULLORE PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE, STIMULIMIN DHE SHPËRBLIMIN E PUNËS KËRKIMORE-SHKENCORE, ARTISTIKE DHE TË APLIKUAR

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e zbatimit

1. Me këtë Rregullore për mbështetjen financiare, stimulimin dhe shpërblimin e punës kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuar (në tekstin e mëtejshëm: "Rregullore"), në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: "Universiteti"), përcaktohen rregullat, procedurat dhe dokumentacioni shoqërues për organizimin, mbështetjen financiare, stimulimin dhe shpërblimin e punës dhe projekteve kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara (në tekstin e mëtejshëm: "veprimtaria") të njësive akademike dhe stafit akademik, në përputhje me Statutin e Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (në tekstin e mëtejshëm: "Statuti") dhe Planin Strategjik të universitetit.
2. Këshilli drejtues i UShAF çdo vit planifikon dhe ndan buxhetin për qëllim të zbatimit të kësaj Rregulloreje, në përputhje me prioritetet e Planit Strategjik të Universitetit.
3. Mjetet financiare të ndara sipas kësaj Rregulloreje planifikohen në mënyrë transparente dhe mund të rialokohen ndërmjet kategorive të veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuar, me vendim të Këshillit Drejtues, në rast se fondet nuk shpenzohen sipas destinimit fillestar.

RB

Neni 2

Fusha e rregullimit

Kjo Rregullore rregullon në veçanti këto çështje::

1. Fushat dhe format e veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuar në Universitet;
2. Organizimin, planifikimin dhe koordinimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara;
3. Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e organeve të Universitetit, stafit akademik dhe kërkimor, si dhe të studentëve pjesëmarrës në veprimtaritë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara;
4. Rolin, kompetencat dhe përgjegjësitë e njësisë/ zyrës përgjegjëse për mbështetjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuar;
5. Themelimin, përbërjen, kompetencat dhe funksionimin e Komisionit për veprimtari kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuar;
6. Mbështetjen financiare, stimulimin dhe shpërblimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara për njësitë akademike, stafin dhe studentët e Universitetit;
7. Procedurat e aplikimit, vlerësimit dhe shpërblimit për veprimtarinë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuar.
8. Procedurat e aplikimit, vlerësimit, përzgjedhjes dhe ndarjes së mjeteve financiare për projektet kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara;
9. Parimet e etikës, integritetit akademik dhe cilësisë së publikimeve shkencore;
10. Transparencën, raportimin dhe të drejtën e ankesës në procedurat e mbështetjes financiare dhe shpërblimit.

Neni 3

Qëllimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore, të aplikuar dhe artistike në Universitet

Universiteti zhvillon veprimtari kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara, përfshirë punë, projekte dhe krijimtari profesionale, me qëllime të:

1. Zhvillimit të vazhdueshëm dhe avancimit të procesit arsimor;
2. Përfshirjen dhe përafrimit të studentëve me kërkimet shkencore dhe të aplikuara, si dhe veprimtaritë artistike;
3. Avancimit të vazhdueshëm shkencor, profesional dhe artistik të stafit akademik;
4. Mbështetjes profesionale të komunitetit dhe zhvillimit të shoqërisë;
5. Promovimit të inovacionit, transferimit të njohurive dhe aplikimit praktik të rezultateve të kërkimit.

RB

6. Zhvillimit të partneriteteve strategjike me industrinë, duke orientuar kërkimin drejt kërkesave reale të tregut dhe duke gjeneruar zgjidhje praktike, që sjellin përfitime për komunitetin e biznesit dhe që ndikojnë në zhvillimin rajonal.

Neni 4

Veprimtaria kërkimore-shkencore, e aplikuar dhe artistike në Universitet

1. Veprimtaria kërkimore-shkencore, e aplikuar dhe artistike sipas kësaj Rregulloreje përfshin punë kërkimore-shkencore, projekte kërkimore-shkencore dhe të aplikuara, krijimtari artistike, publikime shkencore dhe profesionale, publikimin dhe shpërndarjen e rezultateve të punës, aftësimin dhe zhvillimin profesional të stafit akademik dhe shkencor, përfshirjen e studentëve në veprimtari kërkimore, të aplikuara dhe artistike, si dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale të Universitetit, përfshirë inovacionin dhe transferimin e njohurive dhe teknologjisë.
2. Kjo veprimtari përfshin kërkime shkencore dhe të aplikuara, punë krijuese artistike dhe projekte kërkimore-shkencore dhe të aplikuara në përputhje me Ligjin nr. 04/L-135 për veprimtari kërkimore-shkencore, dhe bazohet në parimet e lirisë dhe autonomisë krijuese, konkurrencës së programeve dhe projekteve shkencore dhe artistike, aplikimit të standardeve ndërkombëtare në fushën e shkencës dhe artit, planifikimit dhe vlerësimit të rezultateve të punëve të realizuara, respektimin e etikës profesionale, si dhe bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare përfshirë sektorin e industrisë, të ndërlidhura me sistemin e arsimit të lartë dhe promovimin e përmbajtjeve specifike kombëtare.
3. Veprimtaria kërkimore-shkencore, e aplikuar dhe artistike mund të realizohet brenda Universitetit, në Institutin e Shkencave të Aplikuara (në tekstin e mëtejme: "Institut"), ose në institucione të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në bashkëpunim me partnerë të sektorit privat, sipas nevojës dhe në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

Neni 5

Aktivitetet e veprimtarisë kërkimore-shkencore, të aplikuar dhe artistike në Universitet

Veprimtaria kërkimore-shkencore, e aplikuar dhe artistike në Universitet përfshin një gamë të gjerë aktivitetesh, të cilat zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet akademike kombëtare dhe ndërkombëtare, si në vijim:

RB

1. Publikime shkencore dhe shpërndarje të rezultateve - Punime të botuara në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, artikuj të indeksuar, libra, kapituj librash, si dhe forma tjera të publikimi të rezultateve të punës kërkimore;
2. Konferenca, kongrese, simpoziume, forume dhe tryeza shkencore - pjesëmarrja aktive në konferenca, kongrese, simpoziume, forume dhe tryeza shkencore ndërkombëtare si dhe kombëtare me karakter ndërkombëtar
3. Veprimtari artistike dhe krijuese - pjesëmarrja në veprimtari artistike dhe krijuese origjinale, si ekspozita, performanca, instalacione, projekte dizajni dhe forma të tjera të shprehjes artistike ndërkombëtare si dhe kombëtare me karakter ndërkombëtar
4. Transferim i njohurive, inovacioni dhe pronësia intelektuale - zhvillimi i prototipeve, zgjidhje inovative dhe produkteve të reja, pjesëmarrje në panaire dhe ngjarje ndërkombëtare dhe kombëtare me karakter ndërkombëtar për prezantimin e projekteve dhe produkteve inovative si dhe produkte dhe rezultate me pronësi intelektuale;
5. Përfshirje e studentëve nën mentorim (si autor korrespondent) të stafit akademik - përfshirja e studentëve në publikime, veprimtari kërkimore-shkencore, të aplikuara dhe artistike, zhvillimin e prototipave dhe produkteve inovative për industri, si dhe krijimin e produkteve dhe rezultateve me pronësi intelektuale, të realizuara nën mentorimin e stafit akademik dhe të publikuara ose të prezantuara në nivel ndërkombëtar apo kombëtar me karakter ndërkombëtar.
6. Projekte kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara - projekte të zhvilluara nga njësitë akademike në nivel institucional, kombëtar ose ndërkombëtar, të financuara nga burime publike, private ose donatore, duke përfshirë projekte ndërdisiplinore dhe bashkëpunime me institucione të arsimit të lartë, institucione tjera publike dhe private, qendra kërkimore dhe industri.

Neni 6

Koordinimi i veprimtarisë kërkimore, artistike dhe të aplikuar

Në përputhje me Statutin e Universitetit, Prorektori për mësim, shkencë dhe çështje të studentëve, në bashkëpunim me Zyrën për mbështetjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore, të aplikuar dhe artistike, janë përgjegjës për:

1. Koordinimin e veprimtarive kërkimore-shkencore, të aplikuara dhe artistike në Universitet, në përputhje me misionin, vizionin, vlerat dhe planin strategjik të Universitetit;

RS

2. Hartimin dhe përditësimin e planit vjetor të Universitetit për veprimtari kërkimore-shkencore, të aplikuara dhe artistike, në përputhje me prioritetet strategjike;
3. Koordinimin e prioriteteve dhe aktiviteteve të propozuara nga njësitë akademike dhe stafi akademik, duke siguruar përputhshmërinë me planin strategjik dhe standardet akademike;
4. Nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar shkencor, artistik dhe të aplikuar, përfshirë rrjetet evropiane dhe projektet ndërkombëtare;
5. Monitorimin dhe vlerësimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore, të aplikuar dhe artistike, për të siguruar cilësi, efektivitet dhe përputhshmëri me misionin dhe vizionin e Universitetit.

Neni 7

Zyra për mbështetjen e kërkimeve shkencore

Veprimtaria kërkimore-shkencore, e aplikuar dhe artistike në Universitet koordinohet nga Prorektori për mësim, shkencë dhe çështje të studentëve në bashkëpunim me Zyrën për mbështetjen e kërkimeve shkencore .

Zyra është përgjegjëse për:

- Mbështetjen e aktiviteteve kërkimore shkencore, artistike dhe të aplikuar;
- Monitorimin dhe mbështetjen e aplikimeve për projekte kërkimore-shkencore, të aplikuara dhe artistike, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Mbështetjen e zhvillimit profesional dhe kapaciteteve kërkimore të stafit akademik dhe studentëve, përmes trajnimeve, punëtorive dhe mentorimit;
- Mirëmbajtjen e bazës së të dhënave për veprimtarinë kërkimore-shkencore, të aplikuar dhe artistike, duke përfshirë portalin e brendshëm të shkëmbimit të informacionit;

Neni 8

Përgjegjësitë e stafit akademik

Secili mësimdhënës në Universitet është i obliguar të zhvillojë dhe publikojë aktivitetet e tij kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara, në revista shkencore ndërkombëtare dhe/ose kombëtare, në përputhje me Statutin e Universitetit dhe rregulloret përkatëse në fuqi.

Në kuadër të veprimtarisë së tyre kërkimore dhe të aplikuar, stafi akademik inkurajohet të përfshijnë sektorin e biznesit dhe partnerë nga industria, përmes projekteve të

RS

përbashkëta, përmes hulumtimeve të orientuara drejt kërkesave të tregut, si dhe përmes aplikimit praktik të rezultateve kërkimore.

Stafi akademik mban përgjegjësi për realizimin e aktiviteteve individuale kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara. Për arritjet e tyre, mësime të ndërmjetshme janë të obliguar të njoftojnë Zyrën për Mbështetjen e Kërkimeve Shkencore në baza vjetore, për çdo vit kalendarik.

Në nivel të njësive akademike, koordinimi, mbikëqyrja dhe vlerësimi institucional i aktiviteteve kërkimore-shkencore dhe të aplikuara realizohet nga dekanët e njësive akademike dhe nga Këshilli Mësimor/Shkencor i Universitetit, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me Statut dhe rregullore.

Neni 9

Komisioni për veprimtari kërkimore-shkencore, të aplikuara dhe artistike

Komisioni për veprimtari kërkimore-shkencore, të aplikuara dhe artistike është organi përgjegjës për menaxhimin dhe përkrahjen e veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara në Universitet.

Komisioni përbëhet nga:

- Prorektorët e universitetit
- Prorektori për mësim, shkencë dhe çështje të studentëve ex-officio është Kryesues i komisionit,
- Një përfaqësues i studentëve i deleguar nga Parlamenti studentor i Universitetit,
- Zyrtari për mbështetjen e kërkimeve shkencore,

Në rast të votimit të barabartë, vota e Kryesuesit është e vendimtare.

Në raste të veçanta kur tre anëtarët e këtij komisioni kanë parashtruar kërkesë për mbështetje dhe shpërblim të veprimtarisë, Kryesuesi i Komisionit ka të drejtë që të zëvendësoj anëtarët ad-hoc në konsultim me përgjegjësit e njësive akademike.

Komisioni në raste të caktuara rezervon të drejtën të ftojë ekspert të fushës nga njësit akademike për t'iu ofruar këshilla dhe rekomandime.

Neni 10

Detyrat e komisionit për veprimtari kërkimore-shkencore, të aplikuara dhe artistike

Komisioni ka këto detyra:

RS

- Të propozojë ndryshimet në Rregullore,
- Të shqyrtojë kërkesat për mbështetje dhe shpërblim të veprimtarisë kërkimore-shkencore, të aplikuara dhe artistike;
- Të aprovojë ose refuzoj mbështetjen financiare dhe shpërblimin veprimtarisë në përputhje me kriteret të përcaktuara me këtë rregullore
- Të mbikëqyrë implementimin e projekteve nëpër faza të caktuara.
- Të miratojë ose refuzojë raportet e punës së projekteve, sipas fazave përkatëse.
- Gjatë kohëzgjatjes së thirrjes, të shqyrtojë kërkesat së paku një herë në muaj, dhe në raste të veçanta edhe më shumë se një herë në muaj;
- Të i propozojë Senatit kandidatin për çmimin "Hulumtuesi i Vitit".

Neni 11

Financimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara

1. Financimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara realizohet nga buxheti i Universitetit, i ndarë për veprimtari kërkime shkencore, artistike dhe të aplikuara, si dhe nga kontributet e partnerëve dhe donatorëve të jashtëm.
2. Nga buxheti i Universitetit i ndarë për veprimtari kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara mbulohen aktivitetet kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara të përcaktuara në nenin 5 të kësaj Rregulloreje, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me këtë Rregullore.
3. Lartësia e mjeteve financiare për veprimtari hulumtuese, kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara përcaktohet me buxhetin e Universitetit, të miratuar nga Këshilli Drejtues.

Neni 12

Procedura e mbështetjes financiare dhe shpërblimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore, të aplikuar dhe artistike

1. Procedura e ndarjes së mjeteve financiare për mbështetje dhe shpërblim të veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara nga universiteti zhvillohet mbi bazën e thirrjes publike për aplikim të shpallur me vendim nga Senati. Thirrja hapet një herë në vit bazuar në vendimin e KD-së për ndarjen e mjeteve financiare, dhe mbetet e hapur deri me 15 nëntor të vitit përkatës kalendarik.
2. Në rast se fondet e ndara shpenzohen para datës 15 nëntor, thirrja mbyllet para kësaj date (15 nëntor).
3. Aktivitete e veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuar, të cilat nuk janë mbështetur ose shpërblyer për shkak të shpenzimit të fondeve pas

RS

mbylljes së thirrjes sipas pikave 1 dhe 2 të këtij nënti, gëzojnë të drejtën të aplikojnë në thirrjen e radhës.

4. Gjatë shpalljes së thirrjes publike për mbështetje financiare dhe shpërblim, Universiteti përcakton qartë fusha e mbështetjes financiare, kriteret e vlerësimit, dokumentet e nevojshme për aplikim dhe informata të tjera relevante.
5. Shqyrtimi i kërkesave dhe ndarja e mjeteve financiare dhe shpërblim të veprimtarisë mbi bazën e thirrjes publike zhvillohet sipas dispozitave të parapara të kësaj Rregulloreje.
6. Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave për mbështetje financiare dhe shpërblim bëhet brenda një afati të arsyeshëm kohor, por jo më gjatë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike për punime dhe pjesëmarrje në aktivitete kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara, si dhe për projekte kërkimore shkencore dhe të aplikuara.
7. Për aktivitetet e veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara të cilat e kanë kaluar me sukses procesin e publikimit, të drejtën e aplikimit për mbështetje financiare dhe shpërblim e ka vetëm autori i parë ose autori korrespondent (por jo që të dy).
8. Financimi i veprimtarisë do të bëhet për aq kohë sa ka fonde në buxhetin e alokuar nga Këshilli Drejtues për çdo vit përkatës, duke u zbatuar parimi "i pari për nga koha e dorëzimit të kërkesës është i pari i cili e gëzon të drejtën".
9. Kërkesa protokollohet dhe dorëzohet në administratën e Universitetit brenda afateve të përcaktuara në thirrjen publike. Në rast se konstatohet se dokumentacioni nuk është i kompletuar, komisioni kërkon nga parashtruesi i kërkesës plotësimin e tij. Nëse kandidati nuk e plotëson dokumentacionin brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike, kërkesa konsiderohet e tërhequr.
10. Kërkesa dhe dokumentet e dorëzuara jashtë kohës të përcaktuar në thirrje, nuk do të merren në shqyrtim.
11. Përjashtimisht nga pika 10 e kësaj Rregulloreje, në raste të veçanta dhe të arsyetuara, Komisioni përkatës mund të shqyrtojë kërkesat e paraqitura jashtë afatit të përcaktuar në thirrje, nëse aplikuesi dëshmon se, në periudhën ndërmjet mbylljes dhe hapjes së thirrjes së radhës, ka pasur publikime shkencore të indeksuara në platforma ndërkombëtare (si Scopus apo Web of Science), të cilat për arsye objektive mund të mos jenë më të indeksuara në momentin e hapjes së thirrjes së radhës. Vendimi për shqyrtim në këto raste merret nga Komisioni, bazuar në dokumentacionin mbështetës dhe arsyetimin e paraqitur nga aplikuesi, i cili do të mirret në konsideratë nëse publikimi shkencor mund të mos jetë i indeksuar gjatë aplikimit në thirrjen e radhës.

RS

12. Përfituesi njoftohet me njoftim zyrtar (përmes e-mail) për vendimin përfundimtar të komisionit.

Neni 13

E drejta për mbështetje financiare dhe shpërblim të veprimtarisë kërkimore shkencore, artistike dhe të aplikuar

1. Të drejtën për shpërblim të punës kërkimore shkencore, artistike dhe të aplikuara e kanë personeli akademik i UShAF, të cilët kanë publikuar tërësisht ose pjesë të konsiderueshme të rezultateve të punës së tyre kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara, dhe të cilët paraqesin përkatësinë institucionale (afiliation) të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, për:
 - 1.1. Artikujt origjinal shkencor që bartin adresën e UShAF (affiliation), dhe janë të botuar në revista me recension ndërkombëtar (*peer-review*), të cilat janë të indeksuara në platformat: Clarivate Analytics-Web of Science (SCIE, SSCI, AHCI dhe ESCI) ose SCOPUS (Q1, Q2, Q3, dhe Q4)
 - 1.2. Libra (të shtypur ose elektronikë) dhe kapituj librash, të cilët paraqesin rezultat të kërkimit origjinal të botuara nga shtëpi botuese të indeksuara në *Web of Science* (<http://wokinfo.com/mbl/publishers/>).
 - 1.3. Të gjithë artikujt shkencorë, siç përcaktohen në pikën 1.1 të këtij neni, fitojnë të drejtën për shpërblim vetëm pasi të jenë të indeksuar në platformat Clarivate Analytics – Web of Science (SCIE, SSCI, AHCI dhe ESCI) ose SCOPUS (Q1, Q2, Q3, dhe Q4).
 - 1.4. Librat dhe kapitujt librash të përcaktuar në pikën 1.2 fitojnë të drejtën e shpërblimit vetëm pasi të jenë botuar në shtëpi botuese të përcaktuara në këtë nenë.
 - 1.5. Stafi akademik i universitetit për punë kërkimore shkencore sipas pikave 1.1, 1.2 dhe 1.3 të këtij paragrafi do të shpërblehen sipas tabelës 1.
2. Pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare shkencore, simpoziume, kongrese, punëtori dhe forume shkencore ndërkombëtare dhe vendore me karakter ndërkombëtar.
3. Pjesëmarrjen në veprimtari artistike dhe krijuese si ekspozita, performanca, instalacione, projekte dizajni dhe forma të tjera të shprehjes artistike ndërkombëtare dhe vendore me karakter ndërkombëtar.
4. Transferimin e njohurive dhe inovacionin, të tilla si: zhvillimin e prototipeve, zgjidhjeve inovative, pjesëmarrjen në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare për prezantimin e njohurive, projekteve apo produkteve inovative, si dhe produkte apo rezultate me pronësi intelektuale të prezantuara në nivel ndërkombëtar dhe vendor me karakter ndërkombëtar.

RS

5. Veprimtari kërkimore-shkencore, të aplikuara dhe artistike si dhe veprimtari artistike dhe krijuese, zhvillim i prototipave dhe produkteve inovative për industri, si dhe produkte dhe rezultateve me pronësi intelektuale të studentëve, të realizuara nën mentorimin e stafit akademik (autor korrespondent) dhe të publikuara ose të prezantuara revista, konferenca apo ngjarje në nivel ndërkombëtar apo kombëtar me karakter ndërkombëtar. Në rastet kur veprimtaria kërkimore-shkencore e studentëve, e realizuar nën mentorimin e stafit akademik, është në përputhje me pikat 1.1, 1.2 dhe 1.3 të paragrafit 1 të këtij neni, ajo shpërblehet sipas Tabelës 1 të kësaj rregulloreje; në të kundërtën, për pjesëmarrje në konferenca apo ngjarje në nivel ndërkombëtar apo kombëtar me karakter ndërkombëtar për prezantimin e veprimtarisë, zbatohet Tabela 2 e kësaj rregulloreje.
6. Mbështetja financiare dhe shpërblimi u takon stafit akademik të UShAF-it për aktivitetet e përcaktuara në pikat 2-5 të këtij neni, vetëm në rastet kur ka prezantim të dokumentuar të rezultateve në formë orale, përfshirë pjesëmarrjen në role shkencore ose organizative në ngjarjet e sipërpërmendura, ose përmes prezantimit demonstrativ sipas natyrës së aktivitetit. Në rastet e përcaktuara në paragrafin 5, prezantimi i realizuar nga studenti konsiderohet i vlefshëm edhe për mentorin (autor korrespondent), ndërsa kërkesën për mbështetje financiare mund ta paraqesë autori korrespondent.
7. Stafi akademik, i cili merr pjesë në bordet shkencore, organizative apo ekzekutive të ngjarjeve të tilla, si dhe ata që janë të ftuar si folës, panelistë, kryetarë të takimeve/sesioneve ose në pozicione të ngjashme, kanë të drejtë të aplikojnë për mbështetje financiare vetëm nëse prezantojnë në formë orale rezultate nga fusha e tyre e ngushtë e hulumtimit.
8. Universiteti do të shpërblejë stafin akademik që aplikon në projekte ndërkombëtare Horizon Europe, projekte të tjera me vlerë të barasvlershme buxhetore, si dhe në projekte Erasmus+, kur UShAF është aplikuesi kryesor, respektivisht:
 - 8.1. Bartësi i projektit, i cili ka aplikuar dhe projekti i të cilit ka qenë i suksesshëm duke u pranuar për financim nga Horizon Europe dhe projektet ekuivalente, do të shpërblehet me vlerë prej 3,000 (tre mijë) euro, ndërsa për projektet Erasmus+ me vlerë prej 1,500 (një mijë e pesëqind) euro.
 - 8.2. Bartësi i projektit, i cili ka aplikuar dhe projekti i të cilit ka qenë i suksesshëm, por nuk është financuar për shkak të mungesës së fondeve ose konkurrencës së lartë, do të shpërblehet me vlerë prej 1,000 (një mijë) euro për projektet Horizon Europe dhe ekuivalente, si dhe me vlerë prej 500 (pesëqind) euro për projektet Erasmus+.
 - 8.3. Projektet që janë diskualifikuar për shkak të cilësisë së pamjaftueshme ose për çfarëdo arsye tjetër nuk do të shpërblehen.

9. Mbështetja financiare dhe shpërblimi për veprimtarinë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuar, të siguruar nga Universiteti për stafin akademik, jepen si vlerësim i kontributit akademik të stafit dhe përfitohen pavarësisht nga fakti nëse për të njëjtën veprimtari janë siguruar edhe fonde të tjera nga burime jashtë Universitetit, përfshirë fonde kombëtare apo ndërkombëtare, publike ose private.
10. Në rastet kur pjesëmarrja në aktivitetet e përcaktuara në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni realizohet me prezencë fizike, stafit akademik të universitetit do t'u mbulohen shpenzimet për tarifat e regjistrimit (registration fee), si dhe një pjesë e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të akomodimit, ushqimit dhe udhëtimit, në formë tarife fikse të përcaktuara në Tabelën 2.
11. Në rastet kur pjesëmarrja në aktivitetet e përcaktuara në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni realizohet në formë online (virtuale), stafi akademik ka të drejtë të aplikojë vetëm për mbulimin e tarifës së regjistrimit (registration fee), nëse kjo është e aplikueshme. Mbështetja financiare në këto raste jepet vetëm nëse dëshmohet prezantimi aktiv (oral ose formë ekuivalente) i punimit apo aktivitetit, në përputhje me kërkesat e paragrafëve 6 dhe 7 të këtij neni. Në rastet e pjesëmarrjes online nuk mbulohen shpenzimet akomodimit, ushqimit dhe udhëtimit.
12. Për aktivitetet e veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuar të cilat e kanë kaluar me sukses procesin e publikimit, të drejtën e aplikimit për mbështetje financiare dhe shpërblim e ka vetëm autori i parë ose autori korrespondent (por jo që të dy).
13. Numri maksimal i publikimeve dhe pjesëmarrjeve për të cilat stafi akademik mund të aplikojë për shpërblim dhe/ose mbështetje financiare, sipas paragrafëve 1-4 të këtij neni, përcaktohet si në vijim:
 - 13.1 Për publikimet shkencore sipas paragrafit 1 të këtij neni,, stafi akademik mund të aplikojë maksimalisht për dy (2) publikime në vit, në përputhje me kategoritë dhe vlerat e përcaktuara në Tabelën 1;
 - 13.2 Për aktivitetet e parapara në paragrafët 2-4 të këtij neni, stafi akademik mund të aplikojë maksimalisht për dy (2) pjesëmarrje në vit, sipas kushteve të përcaktuara në Tabelën 2, me këtë shpërndarje:
 - 13.2.1. një (1) pjesëmarrje në vendet e rajonit: Kosovë, Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Bullgari;
 - 13.2.2. një (1) pjesëmarrje në vendet tjera, (përfshirë për vendet e përmendura në 13.2.1), sipas kategorizimit të përcaktuar në Tabelën 2.
 - 13.2.3. Universiteti mbështet financiarisht pjesëmarrjen e stafit akademik në secilin aktivitet të paraparë me paragrafët 2-4 të këtij neni veç e veç, deri në maksimum katër (4) punime në të njëjtën konferencë, simpozium, forum, kongres, veprimtari artistike dhe krijuese si dhe

ngjarje të natyrës së njëjtë të përcaktuara sipas kësaj Rregulloreje. Në rastet kur numri i punimeve të paraqitura nga stafi akademik për një konferencë, simpozium, forum, kongres, veprimtari artistike dhe krijuese si dhe ngjarje të natyrës së njëjtë të përcaktuara sipas kësaj Rregulloreje tejkalon këtë kufi, mbështetja financiare ofrohet vetëm për katër (4) punime, përkatësisht për një (1) përfaqësues për secilin punim. Ky kufizim zbatohet për çdo konferencë, simpozium, forum, kongres, veprimtari artistike dhe krijuese si dhe ngjarje të natyrës së njëjtë të përcaktuara sipas kësaj Rregulloreje individualisht dhe nuk ndërlidhet me shtetin apo vendin e organizimit të saj. Përzgjedhja e punimeve që do të mbështeten bëhet në përputhje me parimin "i pari për nga koha e dorëzimit të kërkesës është i pari i cili e gëzon të drejtën", si dhe në varësi të mjeteve të disponueshme buxhetore, në pajtim me paragrafin 8 të nenit 12 të kësaj Rregulloreje.

13.3 Kufizimet e përcaktuara në pikat 13.1 dhe 13.2 janë të pavarura nga njëra-tjetra, dhe stafi akademik ka të drejtë të aplikojë në të dyja kategoritë, deri në numrin maksimal të përcaktuar për secilën, duke rezultuar në një total deri në katër (4) aplikime në vit (2 publikime shkencore dhe 2 pjesëmarrje në aktivitete kërkimore shkencore, artistike, dhe të aplikuara).

14. Numri maksimal i aplikimeve për publikime shkencore (paragrafi 1 i këtij neni dhe Tabela 1) dhe për pjesëmarrje në aktivitete kërkimore, shkencore, artistike dhe të aplikuara (paragrafët 2-4 i këtij neni dhe Tabela 2) mund të ndryshohet për vitin kalendarik përkatës me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues, në varësi të fondeve të disponueshme nga universiteti.
15. Në rastet kur stafi akademik angazhohet si mentor (autor korrespondent) i studentëve, në përputhje me paragrafin 5, ai ka të drejtë të aplikojë për mbështetje financiare dhe/ose shpërblim edhe për dy (2) aplikime shtesë: një (1) publikim shkencor dhe një (1) pjesëmarrje në aktivitete kërkimore, shkencore, artistike dhe të aplikuara, edhe nëse ka arritur numrin maksimal të aplikimeve sipas paragrafit 13.
 - 15.1. Kjo e drejtë ushtrohet pa cenuar dhe pa humbur të drejtën e tij për aplikim si autor i parë apo autor korrespondent, sipas paragrafëve 1-4, në përputhje me kufizimet e paragrafit 13
 - 15.2. Në rastet e përcaktuara në paragrafin 5, kur prezantimi i veprimtarisë realizohet nga studenti nën mentorimin e stafit akademik, ky prezantim konsiderohet i vlefshëm edhe për mentorin (autor korrespondent) në përputhje me paragrafët 6 dhe 7 të këtij neni, i cili ka të drejtë të bëjë vetë

RS

kërkesën për mbështetje financiare dhe/ose shpërblim për veprimtarinë e studentit.

Tabela 1. Shpërblimi për publikime shkencore

Artikujt shkencor	Shuma e shpërblimit
Web of Sciences IF>5.0	1500
Web of Sciences IF<5.0	1200
Web of Sciences ESCI	400.00 €
Scopus (Q1)	800.00 €
Scopus (Q2)	600.00 €
Scopus (Q3)	400.00 €
Scopus (Q4)	300.00 €
Libër (i shtypur apo elektronik)	2000.00 €
Kapituj librash	200.00 €

Tabela 2. Mbështetja financiare për pjesëmarrje në aktivitete kërkimore shkencore, artistike, dhe të aplikuara

Aktiviteti	Shuma e mbështetjes/shpërblimit
1. Pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare shkencore, simpoziume, kongrese, punëtori dhe forume shkencore ndërkombëtare dhe vendore me karakter ndërkombëtar. 2. Pjesëmarrje në veprimtari artistike dhe krijuese 3. Zhvillim prototipave, zgjidhje inovative, pjesëmarrje në panairë kombëtare dhe ndërkombëtare për prezantim të njohurive, projekteve, produkteve inovative dhe produkte apo artikuj me pronësi intelektuale të prezantuara në konferenca apo ngjarje në nivel ndërkombëtare dhe vendor me karakter ndërkombëtar. 4. Veprimtari kërkimore-shkencore të aplikuara dhe artistike, veprimtari artistike dhe krijuese, zhvillimin e prototipave si dhe produkteve inovative për industri, si dhe produkte dhe rezultateve me pronësi intelektuale të studentëve, të realizuara nën mentorimin (autor korrespondent) e stafit akademik dhe të publikuara dhe të prezantuara në konferenca apo ngjarje në nivel ndërkombëtar apo kombëtar me karakter ndërkombëtar.	Kosovë Tarifa e regjistrimit + 100 euro
	Shqipëri, Maqedoni e Veriut, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Bullgari, Tarifa e regjistrimit + 400 euro
	Kroaci, Greqi, Rumani, Hungari, Slloveni, Turki Tarifa e regjistrimit + 700 euro
	Shtete të Evropës, Azisë Perëndimore, Afrikës Veriore (përfshirë ato që u përmendën më sipër) Tarifa e regjistrimit + 1000 euro
	Shtete tjera të botës (përfshirë ato që u përmendën më sipër) Tarifa e regjistrimit + 1500 euro

RS

Neni 14

Procedura e aplikimit për shpërblim dhe mbështetje të veprimtarisë kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuar

Stafi akademik që përmbush kriteret sipas kësaj Rregulloreje, për aktivitetet e përcaktuara në Tabelat 1 dhe 2, paraqet kërkesë pranë Komisioni për veprimtari kërkimore-shkencore, të aplikuar dhe artistike për shpërblim ose mbështetje financiare në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë nenë, në periudhën deri sa është e hapur thirrja.

Aplikimi bëhet nga autori kryesor ose autori korrespondent. Pagesa e financimit bëhet për artikull, ndërsa rimbursimi i mjeteve realizohet në llogarinë bankare të aplikantit, sipas të dhënave të deklaruara në formularin e aplikimit dhe të verifikuara nga Universiteti.

1. Kërkesën për shpërblim të artikujve/publikimeve shkencore sipas tabelës 1 duhet ti bashkëngjiten dokumentet si në vijim:

- Formulari i kërkesës (Formulari 1) në forme fizike
- Kopje e punimit të publikuar/librit apo kapitullit të librit,
- Dëshmi e indeksimit të punimeve në platformat WoS dhe Scopus, si dhe dëshmi që librat apo kapitujt shkencore janë botuar në shtëpi botuese të përcaktuara në nenin 13 të kësaj Rregulloreje.

2. Kërkesën për mbështetje financiare të pjesëmarrjes në aktivitete kërkimore shkencore, artistike dhe të aplikuar sipas tabelës 2 duhet ti bashkëngjiten dokumentet si në vijim:

- Formulari i kërkesës (Formulari 2) në formë fizike
- Programi i ngjarjes (konferencë, simpozium, punëtori, forum shkencor, veprimtari artistike e krijuese ose panair), me agjendë ku figuron titulli i punimit/produktit/projektit/ekspozitës/performancës/instalacionit dhe emri i autorit.
- Dëshmia (kopje) e punimit/produktit/projektit/ekspozitës/performancës /instalacionit të publikuar/prezantuar si dhe vegëza e publikimit të punimit në librin e abstrakteve dhe punimeve të konferencës/ngjarjes.
- Dëshmia e tarifës së regjistrimit (registration fee)
- Certifikata e pjesëmarrjes (nëse jepet)
- Dëshmi të tjera të pjesëmarrjes (foto, video të prezantimit në konferencë, ku duken ambientet e konferencës dhe vendngjarja me materiale identifikuese (banerë, logo, etj.).

RK

- Dokumentacioni zyrtar i ftesës për aktivitetin apo ngjarjen për kandidatin, në cilësinë e folësit, panelistit, kryetarë të takimeve/sesioneve ose në pozicione të ngjashme
- Dokumentacion zyrtar për kandidatin i cili është pjesë në bordet shkencore, organizative apo ekzekutive të konferencës/ngjarjes.
- Për artikuj me pronësi intelektuale, mjafton vetëm dëshmia e pronësisë
- Dëshmia e udhëtimit dhe akomodimit. Dëshmia e udhëtimit paraqitet përmes biletës së mjetit të udhëtimit (aeroplan, autobus, tren etj.). Në rast se udhëtimi është realizuar me automjet personal, duhet të ofrohet dëshmi e pagesës së taksave rrugore, nëse aplikohet. Nëse në pasaportë është vendosur vulë hyrje/dalje, duhet të ofrohet kopje e faqes përkatëse të pasaportës për ditën e udhëtimit dhe të kthimit. Dëshmia e akomodimit (përrjashtimisht Kosovë) paraqitet përmes faturës së hotelit ose dëshmisë së pagesës online (p.sh. përmes Booking.com, Airbnb ose platformave të tjera të ngjashme).

Neni 15

Çmimi "Hulumtues i vitit"

Bazuar në Ligjin nr. 04/L-135 për veprimtari kërkimore-shkencore, hulumtuesi më i mirë mund të stimulohen deri në 1000 (njëmijë) euro.

1. Senati çdo vit shpall konkursin për Hulumtuesin e vitit në Universitetet dhe vendos kriteret të cilat duhet të plotësohen për të konkurruar për Hulumtuesin e vitit.
2. Komisioni për veprimtari kërkimore-shkencore, të aplikuarat dhe artistike bënë analizën e të gjitha aplikacioneve dhe përzgjedh kandidatin të cilin ja propozon senatit për aprovim. Senati në mbledhjen e parë e bënë shpalljen e Hulumtuesit të vitit.
3. Shpërblimi jepet në vlerë monetare prej 1000 (njëmijë) euro, si dhe në formë jomonetare, përmes ndarjes së një certificate.
4. Përzgjedhja e "Hulumtuesit të vitit" bazohet në:
 - a. Numri i punimeve shkencore;
 - b. Numri i librave të botuar që mbajnë autorësinë e universitetit;
 - c. Numri i monografive të botuara që mbajnë autorësinë e universitetit;
 - d. Numri i projekteve shkencore.
5. Kriteret për çmimin "Hulumtues i Vitit":
 - a. Aplikuesi mund të përdorë vetëm punime ku është autori i parë,
 - b. Punimet duhet të jenë të indeksuara në platformat sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje,

RR

- c. Librat dhe monografite duhet të përkohjnë me fushat e studimit që ofrohen në universitet (me syllabuset e lëndëve që ofrohen në universitet),
- d. Aplikimi për çmimin "Hulumtues i vitit" bëhen vetëm një herë në vit në bazë të thirrjes për aplikim që shpallet në web faqen zyrtare të universitetit,
- e. Dokumentet dhe procedurat tjera të aplikimit do të vendosen në formularin për aplikim për çmimin "Hulumtues i vitit".

Neni 16

Mbështetja financiare për projektet kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara

1. Rregullat e aplikimit:

- a. Të drejtë aplikimi kanë i gjithë personeli i rregullt akademik në universitet,
- b. Projekti si dhe bartësi (koordinatori) i projektit duhet të jenë të fushës së njësisë akademike dhe me interes për Universitetin,
- c. Shuma maksimale financiare do të përcaktohet gjate hapjes së thirrjes e që bazohet në shumën e ndarjes së mjeteve nga Këshilli Drejtues,
- d. Projektet për të cilat është pranuar mbështetje financiare nga institucionet tjera në vend ose jashtë vendi, nuk do të mbështeten nga universiteti,
- e. Hapja e thirrjes do të bëhet vetëm një herë në vit,
- f. Do të mbështetet vetëm një projekt për çdo njësi akademike.
- g. Për çdo njësi akademike mbështetet vetëm një (1) projekt.
- h. Në raste të veçanta dhe të arsyetuara, mund të mbështetet më shumë se një projekt nga e njëjta njësi akademike, me propozim të komisionit dhe miratim të Këshillit Drejtues. Gjithashtu, në rastet kur ndonjë njësi akademike nuk paraqet kërkesë ose kërkesa e paraqitur refuzohet, komisioni mund të propozojë financimin e një projekti shtesë nga njësi tjetër akademike, me miratim të Këshillit Drejtues.
- i. Implementimi i projektit duhet të bëhet brenda vitit kalendarik,
- j. Raportimi për ecurinë (implementimin) e projektit bëhet në zyrën për mbështetjen e kërkime shkencore,
- k. Koordinator (bartësi) i projektit është përgjegjës për implementimin e projektit,
- l. Aplikacioni së bashku me formën e buxhetit, Biografi e shkurtër për secilin anëtar, roli dhe përgjegjësitë, Deklarata e bartësit të projektit dhe Deklaratat e anëtarëve të projektit duhet të protokollohet dhe të dorëzohet në zyrën për mbështetje të kërkimeve shkencore të universitetit në formë fizike.
- m. Bartësi dhe anëtarët e përfshirë në projekt duhet të jenë të punësuar ose student nga UShAF, përjashtim bëjnë ekspertet e jashtëm.

RS

- n. Inkuadrimi i së paku dy studentëve të UShAF (bachelor dhe master)
- o. Shkresë e veçantë e nënshkruar nga përgjegjësi i njësisë akademike që projekti nuk është realizuar asnjëherë më parë në UShAF.
- p. Financimi i projektit do të bëhet në tri faza:
1. 50% e shumës alokohet pas nënshkrimit të projektit. Raporti fillestar duhet të bëhet nga bartësi i projektit me aktivitetet e planifikuara
 2. 30% pas miratimit të raportit intermediar (aktivitetet e realizuara në fazën e parë dhe të planifikuara për fazën e ardhshme).
 3. 20% pas përmbylljes me sukses të projektit (aprovimit të raportit final)
- Lloji i shpenzimeve që lidhen me projektet hulumtuese të cilat mund të mbulohen do të përcaktohen me akte të brendshme të UShAF dhe dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 17

Kriteret e vlerësimit të projekteve hulumtuese, kërkimore-shkencore dhe të aplikuara

Aplikimet që kalojnë vlerësimin teknik/administrativ do të vlerësohen sipas kriterëve si në tabelën e mëposhtme.

Përfituesit do të përzgjidhen mbi bazat konkurruese në përputhje me kriteret e vlerësimit.

Tabela 1. Kriteret e vlerësimit

	Kriteri i vlerësimit	Pikët
1	Përshkrimi i projektit dhe audiencia e synuar direkte	(Vlerësimi: 0-10 pikë)
2	Qëllimi, Objektivat, Aktivitetet dhe Planifikimi kohor	(Vlerësimi: 0-15 pikë)
3	Kualifikimi dhe Eksperienca e Ekipit të Projektit	(Vlerësimi: 0-15 pikë)
4	Menaxhimi i Projektit	(Vlerësimi: 0-10 pikë)
5	Menaxhimi financiar i planifikuar	(Vlerësimi: 0-10 pikë)
6	Rezultatet dhe Përfundimet	(Vlerësimi: 0-15 pikë)
7	Qëndrueshmëria	(Vlerësimi: 0-10 pikë)
8	Inovacioni dhe kreativiteti	(Vlerësimi: 0-5 pikë)
9	Impakti Social ose Ekonomik	(Vlerësimi: 0-3 pikë)
10	Tema ndërsektoriale dhe relevanca me fushat e studimit në UShAF	(Vlerësimi: 0-3 pikë)
11	Projekti udhëhiqet nga një (femër)	(Vlerësimi: 0-2 pikë)
12	Përfshirja e minimum dy studentëve	(Vlerësimi: 0-2 pikë)

RS

Neni 18

E drejta e ankesës

Kundër vendimit të komisionit për punë hulumtuese, kërkimore-shkencore dhe të aplikuar, dhe komisionit për projekte hulumtuese, kërkimore-shkencore dhe të aplikuar, personeli akademik ka të drejtë ankese në afat prej 48 orëve, nga dita e pranimit të vendimit duke ju drejtuar komisionit për ankesa dhe parashtresa në kuadër të Senatit të universitetit, që shërben si shkallë e parë dhe e fundit brenda Universitetit.

Neni 19

Transparenca

1. Me qëllim të realizimit shpenzimeve në mënyrë transparente, UShAF, çdo vit do të publikojë listën përfundimtare të përfituesve nga mbështetja financiare.
2. Lista përfundimtare e përfituesve duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e përfituesit, fushën apo aktivitetin e financuar dhe shumën e ndarë.
3. Publikimi i përfituesve bëhet në faqen zyrtare të Universitetit.

Neni 20

Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

1. Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i UShAF.
2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj Rregulloreje bëhen me procedurë të njëjtë me atë të për miratimin e saj.
3. Çdo veprimtari kërkimore-shkencore, artistike dhe e aplikuar e stafit akademik, përfshirë punimet në revista, pjesëmarrjen në konferenca, kongrese, simpoziume, forume dhe tryeza shkencore, veprimtaritë artistike dhe krijuese, projektet kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuara, e realizuar pas mbylljes së thirrjes sipas Rregullores nr. 3293/24, datë 18.10.2024, të plotësuar/ndryshuar me vendimin nr. 3446/24, të datës 01.11.2024, do të trajtohet sipas rregullave dhe kriterëve të kësaj rregulloreje që hyn në fuqi.
4. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet rregullorja për hulumtime shkencore, subvencionim të punës dhe projekteve hulumtuese, kërkimore-shkencore dhe të aplikuara me nr. 3293/24 e datës 18.10.2024, të plotësuar/ndryshuar me vendimin nr. 3446/24, të datës 01.11.2024.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Dr. Sc. Ramadan Beqiri





UNIVERSITETI

I SHKENCAVE TË APLIKUARA

— FERIZAJ —

FORMULAR I APLIKIMIT PËR SHPËRBLIM TË PUBLIKIMIT SHKENCOR (FORMULARI 1)

1. PARASHTRUESI I KËRKESËS:

EMRI DHE MBIEMRI: _____ THIRRJA SHKENCORE: _____

NJËSIA AKADEMIKE _____ THIRRJA AKADEMIKE: _____

AUTOR KRYESOR: _____

AUTOR KORRESPONDENT: _____

BASHKAUTORËT: _____

2. DETAJËT E PUBLIKIMIT:

TITULLI I
punimit/librit/kapitullit të librit: _____

EMRI REVISTËS: _____

SHTËPIA BOTUESE: _____

DOI: _____

DATA E PUBLIKIMIT: _____ ISSN E REVISTËS: _____

LINKU I PUBLIKIMIT: _____

INDEKSIM I NË PLATFORMËN:
WoS apo SCOPUS (linku) _____

FAKTORI I NDIKIMIT (IF) dhe
(SCIE, SSCI, AHCI apo ESCI)/
SCOPUS (Q1, Q2, Q3, Q4) _____

3. TË DHËNAT BANKARE TË PËRFITUESIT - AUTORIT TË PARË OSE AUTORIT KORRESPONDENT:

EMRI DHE MBIEMRI I
APLIKANTIT: _____

EMRI BANKËS: _____

NUMRI I LLOGARISË
BANKARE: _____

SHUMA E KËRKUAR: _____ EURO SHËNO ME FJALË: _____

4. DOKUMENTET PËRCJELLËSE

- ✓ Kopje e punimit te publikuar.
- ✓ Konfirmimi i xhirlogarisë bankare
- ✓ Kopja e letërnjoftimit

EMRI, MBIEMRI DHE NËNSHKRIMI: _____

DATA DHE VENDI: _____

Pas aplikimit, ky formular duhet të dorëzohet edhe në formë elektronike (në format Word ose PDF, jo i skenuar) në adresën elektronike: zhka@ushaf.net. Dorëzimi në këtë formë është i domosdoshëm për shkak të linkeve të punimeve, të cilat duhet të jenë të qasshme për Komisionin përkatës.



UNIVERSITETI

I SHKENCAVE TË APLIKUARA

— FERIZAJ —

FORMULAR I APLIKIMIT PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË PJESËMARRJES NË AKTIVITETE KËRKIMORE SHKENCORE, ARTISTIKE DHE TË APLIKUARA (FORMULARI 2)

1. PARASHTRUESI I KËRKESËS:

EMRI DHE MBIEMRI: _____ THIRRJA SHKENCORE: _____
NJËSIA AKADEMIKE _____ THIRRJA AKADEMIKE: _____
AUTOR KRYESOR: _____
AUTOR KORRESPONDENT: _____
BASHKAUTORËT: _____

2. DETAJËT E PUBLIKIMIT:

TITULLI I PUNIMIT/PREZANTIMIT: _____
EMRI KONFERENCËS/NGJARJES: _____
VENDI DHE DATA E ORGANIZIMIT: _____
ORGANIZATORI (Universitet, shoqatë profesionale (societies, associations, unions), institute kërkimore ose akademi të shkencave): _____
DATA E PUBLIKIMIT: _____ ISSN ose ISBN: _____
LINKU I PUBLIKIMIT/KONFERENCES: _____

3. TË DHËNAT BANKARE TË PËRFITUESIT - AUTORIT TË PARË OSE AUTORIT KORRESPONDENT:

EMRI DHE MBIEMRI I APLIKANTIT: _____
EMRI BANKËS: _____
NUMRI I LLOGARISË BANKARE: _____
SHUMA E KËRKUAR: _____ EURO SHËNO ME FJALË: _____

4. DOKUMENTET PËRCJELLËSE

- ✓ Dokumentet sipas pikës 2 të nenit 14 të rregullores për mbështetje financiare, stimulim dhe shpërblim të punës kërkimore-shkencore, artistike dhe të aplikuar
- ✓ Konfirmimi i xhirollogarisë bankare
- ✓ Kopja e letërnjoftimit

EMRI, MBIEMRI DHE NËNSHKRIMI: _____

DATA DHE VENDI: _____

Pas aplikimit, ky formular duhet të dorëzohet edhe në formë elektronike (në format Word ose PDF, jo i skenuar) në adresën elektronike: zhka@ushaf.net. Dorëzimi në këtë formë është i domosdoshëm për shkak të linkeve të punimeve, të cilat duhet të jenë të qasshme për Komisionin përkatës.